



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 960/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Aleancës Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak manipulimit të votuesve, në seancën e panelit të mbajtur me 27.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë

Arsyetim

Me datën 25. 11. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga AKR, në të cilën pretendohet se kandidati për kryetar komune nga subjekti politik AAK, Pal Lekaj kërcënon komunitetin RAE duke tentuar që me çdo kusht të orientojë votën ndaj partisë së tij dhe duke bërë shkelje serioze të drejtave të njeriut. Parashtruesi i ankesës thekson se zyrtarët e AAK-së kanë filluar një aksion, kinse humanitar, në pjesë të ndryshme të qytetit ku banojnë komunitetet RAE, duke shpërndarë miell por njëkohësisht duke ua kërkuar letërnjoftimet të gjithë atyre që i marrin këto ndihma, me kërcënimin se do ta zbulojnë se për kë do të votojnë në datën 1 dhjetor. Pretenduesi i ankesës potencon se AKR në vazhdimësi ka pranuar ankesa nga banorët e lagjes Sefë, Kolonisë, Brekocit dhe Dardanisë, pjesë këto të banuara nga komunitetet RAE, që rregullisht janë nën vëzhgim të militantëve të AAK-së dhe prezenca e tyre po ngjallë frikë dhe presion. Sipas parashtruesit të ankesës në lagjen Sefë shpërndarja e ndihmave është organizuar nga një person me emrin Bujar Nezaq kurse shpërndarja është bërë nga personat me emrin Milot Roka dhe Gëzim Spahija. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi lidhur me shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 26.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 27.11.2013, ora 12:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga AAK-ja dhe deklaroi se shpërndarja e miellit apo çfarë do qoftë që është e paraqitur në ankesë nuk është bërë nga strukturat apo simpatizantët e AAK-së dhe se dëshmitë e paraqitura në këtë ankesë nuk vërtetojnë dhe nuk ka asnjë fakt të qartë se rasti në fjalë është bërë nga AAK sepse në fotot e paraqitura si argumente mund të jetë kushdo. Sipas përgjigjes në ankesë, AAK thekson se lidhur me atë se kërcënimet janë bërë nga militantët e AAK-së ashtu siç ka pretenduar parashtruesi i ankesës nuk qëndrojnë dhe janë shpifje ordinere, jo demokratike dhe të rrezikshme për të dezinformuar opinionin publik. AAK në përgjigjen e tyre konfirmon që me të pranuar njoftimin për ankesë ka kontaktuar strukturat menaxhuese të fushatës konkretisht shtabin zgjedhor për komunën e Gjakovës, për të bërë sqarimin lidhur me këtë ankesë.

Përgjigjes në ankesë AAK ka bashkangjitur disa prova, Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së, për respektimin Ligjit mbi zgjedhjet dhe rregulloret të KQZ-së 21 gusht 2013, emaillet zyrtar të shtabit zgjedhor në komunën e Gjakovës, kërkesën drejtuar shefave të shtabeve zgjedhore për respektim të Kodit Zgjedhor të datës 04 tetor 2013.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore të subjektit politik AKR nuk qëndrojnë me atë se militantët e subjektit politik AAK në Komunën e Gjakovës kanë filluar një aksion humanitar duke shpërndarë miell në lagjet e banuara të komuniteteve RAE dhe duke kërcënuar votuesit e këtyre komuniteteve. Ngase dëshmitë e ofruara nga pala ankuese nuk janë të asaj natyre për ti vërtetuar pretendimet ankimore. Shpërndarja e miellit për qëllime humanitare nuk bie ndesh me asnjërën nga pikat a, b, c, d, e, f, g, h, j, k, l, m dhe i të nenit 33 të LZP-së, me të cilin ndalohen veprimet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Prandaj pretendimet e tilla ankimore janë të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe në dëshmi bindëse, andaj PZAP-i mbi këtë bazë si dhe duke u mbështetur në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 960/2013 më datën 27.11.2013.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*